

REZOLUTË

Duke mbajtur parasysh interesat strategjike të vendit dhe ata kombëtarë, të cilave u shërben integrimi europian dhe euroatlantik i Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë historike që ka dhe ndihmesën që sjell ky proces për Shqipërinë, për shqiptarët në Kosovë, në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbi e Mal i Zi dhe shqiptarët që jetojnë e punojnë në vendet e bashkësisë euroatlantike;

Duke e konsideruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE, si një hap tjetër institucionalizues të procesit historik të integritit tonë europian dhe njëherësh si mekanizëm, që çon përpara reformat modernizuese në çdo sektor dhe afron vendin me standardet e BE-së;

Duke njohur natyrën komplekse dhe rrjedhimisht gjithëpërfshirëse të këtij procesi, si dhe ndihmesën që jep e duhet të japë në ecurinë e tij dhe në interes të të gjithëve çdo institucion, çdo faktor i shoqërisë e deri çdo shtetas;

Duke iu referuar rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të muajit prill 2003, lidhur me procesin e negociatave për stabilizim-asociim;

Duke vlerësuar pozitivisht ecurinë e negociatave dhe veçanërisht progresin e arritur, që nga hapja e tyre e deri më sot, në të gjithë sektorët;

Duke konsideruar ndihmesat e dhëna në këtë proces, sipas natyrës dhe detyrimeve kushtetuese e ligjore, nga institucionet përkatëse legislative dhe ekzekutive;

Duke bërë bilancin e efekteve pozitive të domosdoshme, të qëndrueshme e afatgjata të zbatimit të reformave, por edhe të problemeve sociale kalimtare që ato gjenerojnë në disa drejtime, si dhe të shqetësimeve që sjellin për kategori të caktuara të shoqërisë;

Duke vlerësuar pozitivisht si detyrimet në vazhdim dhe ato të pritshme, të gjitha kërkesat që burojnë natyrshëm nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ashtu edhe mundësitë në rritje që jep vetë periudha kohore e domosdoshme për negociatat, nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, pas miratimit të saj dhe nga institucionet përkatëse të BE-së e të vendeve anëtare,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Nxiti dhe mbështet Qeverinë e Republikës së Shqipërisë që të përfundojë negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit brenda këtij viti.

2. Ngarkon qeverinë që të vazhdojë zbatimin e të gjitha reformave që janë attribute të saj dhe që i shërbejnë drejtpërdrejt përmbushjes së kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Në këtë kuadër, ajo duhet të thellojë reformat në ekonomi, përfshirë privatizimet e mëtejshme të sektorëve strategjikë, të shtojë punën për aftësimin e administratës publike dhe decentralizimin, të vazhdojë vendosmërisht luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve dhe korrupsionit, të minimizojë ekonominë informale dhe evazionin fiskal, të shtojë mbledhjen e të ardhurave dhe të optimizojë përdorimin e fondeve publike.

3. Gjithashtu ngarkon qeverinë, që krahas thellimit të reformave për arritjen e standardeve të kërkuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, të vazhdojë të nxisë realizimin e zgjidhjeve për zbutjen e efekteve sociale të reformave, sidomos gjatë periudhës së përshtatjes me situatat e reja të ekonomisë së tregut, kur nisma e lirë dhe sektori privat janë përfundimisht faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit dhe kur, krahas efekteve pozitive të liberalizimit të këmbimeve ndërkombëtare, duhen përballuar edhe ndikimet negative.

4. T'u bëhet e njohur të gjithë faktorëve vendas, pa asnjë përjashtim, matrica e përgatitur nga qeveria, për kërkesat që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe masat e domosdoshme për përmbushjen e saj; gjithashtu qeveria, me shpjegimet përkatëse, të ndihmojë veçanërisht opinionin e gjerë publik me njohjen e kërkesave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, masat e domosdoshme për plotësimin e tyre dhe efektet përkatëse afatshkurtra dhe afatgjata që objektivisht sjell ky proces.

5. I kërkon qeverisë të vazhdojë intensivisht punën me Komisionin Europian dhe me qeveritë e vendeve anëtare dhe atyre të asociuara të BE-së, në shërbim të përfundimit me sukses dhe zbatimit të përbashkët të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE.

6. Gjithashtu, i kërkon qeverisë të tregojë një vëmendje të veçantë për fuqizimin e kapaciteteve administrative të Ministrisë së Integrimit European dhe trajtimin e tyre financiar, si dhe fuqizimin e kompetencave të saj në raport me strukturat e integrimit pranë ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

7. U kërkon të gjitha institucioneve të tjera shtetërore, përfshirë edhe sistemin gjyqësor dhe prokurorinë, që të plotësojnë angazhimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe procesi i integrimit european.

8. Fton të gjithë faktorët politikë dhe të shoqërisë civile, çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë, që të vazhdojë të japë ndihmesën e vet të domosdoshme për mbarëvajtjen e gjithë procesit të Stabilizim-Asociimit të vendit tonë me BE-në.

9. Do të nxisë dhe do të mbështesë plotësimin e gjithë reformës së domosdoshme në shërbim të përafrimit gradual të legjislacionit shqiptar me atë komunitar.

10. Gjithashtu, nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve me parlamentet e vendeve anëtare dhe të asociuara të BE-së, si dhe me vetë Parlamentin European, të nxisë përfundimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE dhe për të siguruar ratifikimin e saj në kohën më të afërt të mundshme.

Tiranë më, 8.3.2004